



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Kancelarija premijera - Office of The Prime Minister
Zyra e Komisionerit për Gjuhët - Kancelarija poverenika za jezike
Office of the Language Commissioner

RAPORT

NIVELI I ZBATIMIT TË LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE
NË KOMUNA DHE GJYKATA THEMELORE

IZVEŠTAJ

PRIMENA ZAKONA O UPOTREBI JEZIKA U OPŠTINAMA
I OSNOVNIM SUDOVIMA

Mars/Mart
2024

Përmbajtja

Hyrje	2
Qëllimi i raportit	4
Metodologjia	5
STRUKTURA E RAPORTIT	7
VLERËSIMI I PËRGJITSHËM	8
VLERËSIMI SPECIFIK	10
- Përkthyesit në Komuna dhe Gjykata	10
- Kontraktimi i shërbimeve gjuhësore	12
- Mbledhjet e Kuvendit	13
- Formularët dhe shërbimet me qytetarë	13
- Mbishkrimet dhe shenjat orientuese	15
- Ankesat e qytetarëve	16
- Faqja zyrtare e internetit	16
PËRFUNDIM	18
- Kërkesat drejtuar ZKGGJ-së	19
- Rekomandime të përgjithshme	19
- Rekomandime specifike	20
- Korniza Ligjore	20

Sadržaj

Uvod	2
Svrha izveštaja	4
Metodologjia	5
STRUKTURA IZVEŠTAJA	7
OPŠTA PROCENA	8
SPECIFIČNA PROCENA	10
- Prevodioci u opštinama i sudovima	10
- Ugovaranje jezičkih usluga	12
- Sednice skupštine	13
- Obrasci i usluge sa građanima	13
- Natpisi i orijentacioni znaci	15
- Žalbe građana	16
- Zvanična internet stranica	16
ZAKLJUČAK	18
- Zahtevi upućeni KPJ-u	19
- Opšte preporuke	19
- Specifične preporuke	20
- Pravni Okvir	20

Shkurtesat

ZKGGJ - Zyra e Komisionerit për Gjuhët
GJTH - Gjykata Themelore
LPGJ - Ligji për Përdorimin e Gjuhëve
IAP - Institucioni i Avokatit të Popullit
IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migracion
MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Skraćenice

ZPJ - Kancelarija poverenika za jezike
OS - Osnovni Sud
ZUJ - Zakon o upotrebi jezika
IO - Institucija zaštitnika građana
IOM - Međunarodna organizacija za migracije
MALS - Ministarstvo administracije lokalne samouprave
UNMIK - Misija Ujedinjenih nacija na Kosovu

HYRJE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës siguron që Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në nivel qendror dhe gëzojnë status të barabartë. Përveç kësaj, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve (LPGJ), më tutje Ligji, qartëson statusin e gjuhëve zyrtare në nivel qendror, gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në nivel lokal. Kjo nënkupton se përveç Gjuhës Shqipe dhe Serbe, gjuhë zyrtare në nivel lokal janë edhe Gjuha Turke dhe Boshnjake. Gjuha Turke, Boshnjake dhe Rome, janë po ashtu gjuhë në përdorim zyrtar në disa komuna të Kosovës. Secila komunë, në kuadër të akteve ligjore Komunale, ka të përcaktuar se cilat gjuhë janë zyrtare e cilat në përdorim zyrtar. Prandaj organet komunale janë të obliguara ti përgjigjen qytetarëve siç përcaktohet në dispozitat ligjore.

Projekti “Avansimi i të drejtave gjuhësore” filloi në vitin 2022 (faza e parë), ndërsa në tetor 2023 filloi të zbatohet i dyti me titull “Promovimi dhe avancimi i të drejtave gjuhësore në Kosovë” dhe do të zgjasë deri në maj të vitit 2024. Ky projekt po zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), e financuar nga UNMIK-u, ndërsa palët/partnerët kryesorë janë ZKGGJ-së dhe IAP.

Një nga aktivitetet e rëndësishme të këtij projekti është monitorimi i Komunave dhe Gjykatave Themelore të komunave përkatëse. Përveç monitorimit të ueb faqeve të tyre, ZKGGJ-ja për herë të parë ka bërë monitorimin e Gjykatave Themelore në teren.

Në fokus të këtij monitorimi, Grupi Punues i projektit përzgjedhi 7 (shtatë) Komuna dhe Gjykata Themelore të komunave përkatëse: Komunën e Graçanicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit, Mitrovicës së Veriut, Mitrovicës së Jugut dhe Prishtinës.

Është e rëndësishme të theksojmë se, gjatë monitorimit të bërë Komunave në vitin 2019, të gjeturat tregonin se Komunitat e Republikës së Kosovës kishin arritur një fazë më të avancuar institucionale dhe ligjore në mbrojtjen e të

UVOD

Ustav Republike Kosovo obezbeđuje da albanski i srpski jezik i njihova pisma budu zvanični jezici na centralnom nivou i da uživaju jednak status. Pored toga, Zakon br. 02/L-37 o upotrebi jezika (ZUJ), u daljem tekstu Zakon, pojašnjava status službenih jezika na centralnom nivou, službenih jezika i jezika u službenoj upotrebi na lokalnom nivou. Ovo podrazumeva da su pored albanskog i srpskog jezika, službeni jezici na lokalnom nivou i turski i bosanski. Turski, bosanski i romski su takođe jezici u službenoj upotrebi u nekim opštinama Kosova. Svaka opština je, u okviru opštinskih zakonskih akata, propisala koji su jezici službeni, a koji u službenoj upotrebi. Stoga, opštinski organi su dužni da odgovore građanima kao što je to propisano zakonskim odredbama.

Projekat „Unapređenje jezičkih prava“ počeo je 2022. godine (prva faza), dok je u oktobru 2023. godine počeo da se sprovodi drugi deo pod nazivom „Promovisanje i unapređenje jezičkih prava na Kosovu“ koji će trajati do maja 2024. godine. Ovaj projekat sprovodi Međunarodna organizacija za migracije (IOM), koju finansira UNMIK, dok su glavni akteri/partneri KPJ i IOP.

Jedna od važnih aktivnosti ovog projekta je praćenje rada opština i osnovnih sudova odgovarajućih opština. Pored praćenja njihovih internet stranica, KPJ je po prvi put vršila praćenje osnovnih sudova na terenu.

U centru pažnje ovog praćenja, radna grupa projekta je odabrala 7 (sedam) opština i osnovnih sudova odgovarajućih opština: Opština Gračanica, Peć, Prizren, Gnjilane, Severna Mitrovica, Južna Mitrovica i Priština.

Važno je naglasiti da su, tokom praćenja izvršenog za opštine u 2019. godini, nalazi pokazali da su opštine Republike Kosovo dostigle napredniju institucionalnu i pravnu fazu u zaštiti jezičkih prava. U međuvremenu, podaci iz praćenje izvršenog u okviru ovog projekta su

drejtave gjuhësore. Ndërkaq, të dhënat nga monitorimi i bërë në kuadër të këtij projekti, ka nxjerrë në pah mangësitë në përmbushjen e obligimeve ndaj qytetarëve dhe rënien e nivelit të zbatimit të Ligjit.

Një gjë shumë e rëndësishme vërehet se në Komunitet e Kosovës nuk ka politika diskriminuese nga administratat komunale ndaj njërës apo tjetrës gjuhë, kur bëhet fjalë për ofrimin e shërbimeve publike. Megjithatë, Komunitet vazhdojnë të funksionojnë me kapacitete jo të mjaftueshme në zbatimin e të drejtave gjuhësore, që nënkupton se për të kryer shërbime ndaj qytetarëve jo-shumicë, në gjuhën e tyre zyrtare (varësisht nga komuna) paraqiten shumë mangësi dhe sfida.

Zyrtarët komunalë, shprehin vullnetin dhe përpjekjen që komunitet të avancojnë barazimin e gjuhëve zyrtare, por në vazhdimësi përmendin buxhetin si problemin kryesor, por edhe mungesën e kapaciteteve (kuadrove profesionale), në përmbushjen e obligimeve ndaj qytetarëve.

ukazali na nedostatke u ispunjavanju obaveza prema građanima i smanjenje stepena primene Zakona.

Veoma je važno da u opštinama Kosova ne postoje diskriminatorne politike od strane opštinskih administracija prema jednom ili drugom jeziku, kada je u pitanju pružanje javnih usluga. Međutim, opštine nastavljaju da rade sa nedovoljnim kapacitetima u sprovođenju jezičkih prava, što znači da u pružanju usluga nevećinskim građanima na njihovom službenom jeziku (u zavisnosti od opštine) postoji mnogo nedostataka i izazova.

Opštinski službenici izražavaju volju i trud da opštine unaprede ravnopravnost službenih jezika, ali kao glavni problem neprekidno pominju budžet, ali i nedostatak kapaciteta (stručnog kadra) za ispunjavanje obaveza prema građanima.



Fig. 1 Procesi i monitorimit për nivelin e respektimit të të drejtave gjuhësore dhe raporti i ZKGGJ-së
Slika 1: Proces praćenja za nivo poštovanja jezičkih prava i izveštaj KPJ-a

QËLLIMI I RAPORTIT

Komunat janë institucionet që kanë nivelin më të afërt të qeverisjes për qytetarin, prej nga burojnë shërbimet publike, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në standardin dhe jetën e qytetarëve. Nga ky këndvështrim, përveç se është dera e parë ku qytetari troket, Komunat janë institucione të cilat duhet të krijojnë kushtet e nevojshme për të kryer shërbimet ndaj qytetarëve, me kohë dhe duke zbatuar në përpikëri të drejtat gjuhësore, si dhe duke iu ofruar shërbimet në gjuhët e tyre zyrtare.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjet përkatëse, për zbatimin e të drejtave të njeriut rol të veçantë luajnë Gjykatat Themelore. Gjuha është mjet themelor në zgjidhjen e rasteve dhe kontesteve të qytetarëve, kështu që edhe një pjesë e konsiderueshme e legjislacionit të Kosovës përveç që e përcaktojnë statusin e gjuhëve zyrtare, ato nënvizojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave gjuhësore dhe obligojnë institucionet Komunale dhe Gjykatat në zbatimin e dispozitave ligjore.

Prandaj, qëllimi i këtij raporti është të analizojë dhe vlerësojë nivelin e zbatimit të Ligjit dhe respektimin e të drejtave gjuhësore në këto Komuna të Republikën së Kosovës, si dhe në Gjykatat Themelore të këtyre komunave. Qëllim tjetër i këtij raporti është të konstatojë gjendjen reale, sfidat me të cilat Komunat dhe Gjykatat ballafaqohen, si dhe nivelin e gatishmërisë së tyre, për t'iu dalë përballë kërkesave të qytetarëve.

Ky raport përmbledh të gjeturat nga vizitat në teren dhe rekomandimet për respektimin e të drejtave gjuhësore, që do të jepen për në Komunat: Graçanicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë e Jugut dhe Prishtinë.

Qëllimi përfundimtar i këtij raporti është që pas identifikimit të sfidave dhe mangësive që kanë Komunat dhe Gjykatat në përmbushjen e obligimeve ndaj qytetarëve, ZKGGJ-ja të adresojë rekomandimet e përgjithshme dhe specifike, me qëllim që të obligojë edhe një herë institucionet

SVRHA IZVEŠTAJA

Opštine su institucije koje imaju najbliži nivo vlasti građanima, odakle potiču javne usluge, koje direktno utiču na standard i život građana. Sa ovog stanovišta, izuzev što su prva vrata na koja građanin kuca, opštine su institucije koje moraju da stvore neophodne uslove za pružanje usluga građanima, blagovremeno i tačno ostvarujući jezička prava, kao i pružanje usluga na njihovim službenim jezicima.

Na osnovu Ustava Republike Kosovo i odgovarajućih zakona, osnovni sudovi igraju posebnu ulogu u sprovođenju ljudskih prava. Jezik je osnovno sredstvo u rešavanju slučajeva i sporova građana, tako da značajan deo kosovskog zakonodavstva, pored propisivanja statusa službenih jezika, podvlači zaštitu i poštovanje jezičkih prava i obavezuje opštinske institucije i sudove da sprovode zakonske odredbe.

Stoga je svrha ovog izveštaja da analizira i proceni nivo primene Zakona i poštovanje jezičkih prava u ovim opštinama Republike Kosovo, kao i u osnovnim sudovima ovih opština. Druga svrha ovog izveštaja je da se utvrdi stvarno stanje, izazovi sa kojima se suočavaju opštine i sudovi, kao i stepen njihove spremnosti da izađu u susret zahtevima građana.

Ovaj izveštaj daje sažetak nalaza iz poseta na terenu i preporuka za poštovanje jezičkih prava, koje će biti date opštinama: Gračanica, Peć, Prizren, Gnjilane, Severna Mitrovica, Južna Mitrovica i Priština.

Konačna svrha ovog izveštaja je, nakon identifikovanja izazova i nedostataka koje opštine i sudovi imaju u ispunjavanju obaveza prema građanima, da se KPJ pozabavi opštim i konkretnim preporukama, kako bi još jednom obavezala određene institucije da sprovode Zakon,

e caktuara, të zbatojnë Ligjin, si dhe rikujtojë të njëjtat për përgjegjësitë që kanë karshi të drejtave gjuhësore.

METODOLOGJIA

Sipas mandatit që ka ZKGJ-ja është e obliguar të bëjë monitorimin dhe raportimin për zbatimin e LPGJ-së dhe respektimin e të drejtave gjuhësore në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Në rastin konkret fillimisht janë përzgjedhur Komunitat dhe Gjykatat, janë monitoruar ueb faqet e tyre, për të vazhduar pastaj monitorimin në teren. Përmes postës elektronike është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës (institucion ky që është i familjarizuar me mandatin e ZKGJ-së), që ZKGJ –ja së bashku me Avokatin e Popullit do të zhvillojnë vizita monitoruese në Gjykatat Themelore të komunave të cekura si më lart. Më pastaj, përmes postës elektronike po ashtu, janë njoftuar të gjitha këto institucione (deri te tre zyrtarë), ku është kërkuar konfirmimi i marrjes së e-mailit dhe kush do të presë zyrtarët monitorues.

Zyrtarët e ZKGJ-së dhe Avokatit të Popullit, kanë vizituar secilën Komunë dhe Gjykatë veç e veç, kanë mbajtur takime diku me kryetarë të komunave (Prizren dhe Gjilan), kryetarë të gjykatave (Graçanicë, Gjilan, Pejës), nënkryetarë të komunave, administratorë të gjykatave, si dhe zyrtarë tjerë. Vizitat monitoruese për këto Institucione kanë zgjatur rreth dy javë.

Ekipi monitorues, gjatë këtyre takimeve ka sqaruar qëllimin e vizitës monitoruese dhe ka marrë pamje (foto) nga takimet dhe tabelat orientuese nëpër këto institucione.

kao i podsećajući ih na odgovornosti koje imaju prema jezičkim pravima.

METODOLOGJIA

U skladu sa mandatom koji KPJ ima, dužna je da prati i izveštava o primeni ZUJ-a i poštovanju jezičkih prava u svim institucijama Republike Kosovo. U konkretnom slučaju, prvo su izabrane opštine i sudovi, praćene su njihove internet stranice, kako bi se potom nastavilo praćenje na terenu. Sudski savet Kosova (institucija koja je upoznata sa mandatom KPJ-a) je, putem elektronske pošte, obavestien da će KPJ zajedno sa zaštitnikom građana obaviti posete za praćenje osnovnih sudova gore navedenih opština. Zatim su, takođe putem elektronske pošte, obavestene sve ove institucije (do tri službenika), pri čemu je tražena potvrda o prijemu elektronske poruke i ko će dočekati službenike za praćenje.

Službenici KPJ-a i zaštitnik građana su posetili svaku opštinu i sud posebno, negde se održavali sastanke sa predsednicima opština (Prizren i Gnjilane), predsednicima sudova (Gračanica, Gnjilane, Peć), zamenicima predsednika opština, administratorima sudova, kao i drugim službenicima. Terenske posete ovim institucijama su trajale oko dve nedelje.

Tim za praćenje je tokom ovih sastanaka razjasnio svrhu terenskih poseta i napravio slike (fotografije) sa sastanaka i tabli za orijentaciju u ovim institucijama.

Vizitat janë bërë për të parë për së afërmi gjendjen dhe nivelin e zbatimit të drejtave gjuhësore në Komuna dhe Gjykata, si dhe gatishmërinë e zyrtarëve për të zgjidhur çështjet e qytetarëve në të dy gjuhët, si dhe tejkalimin e sfidave me të cilat ata ballafaqohen në kohë reale.

Gjatë punës në teren, ekipi monitorues ka hasur në sfida për shkak të mos-informimit të mirë brenda-përbrenda institucionit, në disa institucione, (edhe pse njoftimi ishte bërë me kohë). ZKGGJ-ja në të gjitha institucionet ka Personat kontaktues, të cilët ndihmojnë në rastet kur janë trajtuar të drejtat gjuhësore, por për faktin se janë bërë shumë ndryshime dhe lëvizje nëpër institucione, në shumë raste kanë munguar personat kontaktues. Për mungesën e tyre, Zyra nuk ka marrë asnjë njoftim paraprak, (siç është pensionimi i disave, ndërrimi i vendit të punës etj.), përdërisa adresat e tyre gjenden ende në ueb sajtet e Komunave. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit brenda-përbrenda vet institucionit, mosdhënia e informatave të nevojshme me kohë, si dhe neglizhenca për të trajtuar çështjen, janë disa nga sfidat e shumta që hasen në teren.

Siç u përmend edhe më lart, gjatë zhvillimit të takimeve me përfaqësuesit e institucioneve, janë bërë pyetje të ndryshme që kanë të bëjnë me gjuhët, siç janë: sa përkthyes keni? A keni kompani të përkthimit të kontraktuar? A përkthehen mbledhjet e Kuvendit si dhe materiali përcjellës? A janë lajmet e përkthyer me kohë? Pse ka jo-përputhshmëri gjuhësore në faqen zyrtare të internetit? Etj.

Janë marrë shënime dhe foto nga tereni, të cilat do të jenë pjesë e këtij raporti, por në disa komuna për shkak të mungesës së koordinimit të brendshëm, gjatë vizitës ka ndodhur që të pritët deri sa të merren vesh se kush do të pres zyrtarët monitorues. Po ashtu ka pasur raste kur edhe përkundër faktit se ekipi është prezantuar, është penguar për të marrë pamje për mbishkrimet, tabelat orientuese dhe tabela e njoftimeve.

Posete su vršene kako bi se izbliza sagledalo stanje i stepen ostvarivanja jezičkih prava u opštini i sudovima, kao i spremnost službenika da rešavaju pitanja građana na oba jezika, kao i prevazilaženje izazova sa kojima se suočavaju u realnom vremenu.

Tokom rada na terenu, tim za praćenje je naišao na izazove zbog nedostatka dobre informisanosti unutar institucije, u pojedinim institucijama (iako je obaveštenje obavljeno blagovremeno). KPJ u svim institucijama ima lica za kontakt, koje pomažu u slučajevima kada se rešavaju jezička prava, ali zbog činjenice da je bilo mnogo promena i pomeranja u institucijama, u velikom broju slučajeva lica za kontakt su izostajala. Za njihov izostanak, Kancelarija nije dobila nikakva prethodna obaveštenja (poput penzionisanja nekih, promena radnog mesta, itd), a njihove adrese su i dalje dostupne na internet stranicama opština. Nedostatak saradnje i koordinacije unutar same institucije, izostanak blagovremenog pružanja potrebnih informacija, kao i nemar za rešavanje ovog pitanja, neki su od mnogih izazova sa kojima se susreću na terenu.

Kao što je već pomenuto, tokom sastanaka sa predstavnicima institucija su postavljana razna pitanja u vezi sa jezicima, kao što su: Koliko prevodilaca imate?; Da li imate ugovorene prevodilačke kompanije?; Da li se prevode sednice Skupštine, kao i prateći materijal?; Da li su blagovremeno vesti prevedene?; Zašto postoji jezička neusklađenost na zvaničnoj internet stranici? itd.

Napravljene su beleške i fotografije sa terena, koji će biti deo ovog izveštaja, ali se u pojedinim opštinama, zbog nepostojanja unutrašnje koordinacije, tokom posete dešavalo da čekaju dok se ne dogovori ko će dočekati službenike za praćenje. Takođe je bilo slučajeva da je, uprkos činjenici da je tim predstavljen, bilo onemogućeno da napravi fotografije natpisa, tabli i oglasnih tabli.



Gjatë monitorimit / Tokom nadgledanja

STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti përmban pjesën hyrëse, qëllimin dhe metodologjinë e zhvillimit të monitorimit, të gjeturat e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe rekomandimet e dhëna për institucionet e monitoruara.

Fillimisht është qartësuar qëllimi i vizitave monitoruese dhe i përpilimit të raportit, si finalizim i projektit në përgjithësi.

Raporti vazhdon me shpjegimin e metodologjisë së përdorur për mbledhjen e të dhënave, çfarë procedurash, mjeteve dhe hapash janë përdorur për të arritur deri te qëllimi i paracaktuar, si dhe paraqet një numër sfidash që janë hasur gjatë monitorimit. Të dhënat e vendosura në raport, janë bërë në formë të shkruar dhe në formë grafike.

Pjesa e tretë paraqet vlerësimin e përgjithshëm dhe vlerësimin specifik. Përfshinë kapacitetin e brendshëm gjuhësor profesional të Komunave dhe Gjykatave, numrin e përkthyesve, kontraktimin e shërbimeve gjuhësore, si dhe nivelin e komunikimit dhe bashkëpunimit brenda- përbrenda institucionit. Vëmendje e veçantë gjatë monitorimit i është kushtuar gatishmërisë së

STRUKTURA IZVEŠTAJA

Izveštaj sadrži uvodni deo, svrhu i metodologiju praćenja razvoja, opšte i specifične nalaze, kao i preporuke date praćenim institucijama.

Najpre je razjašnjena svrha terenskih poseta i sastavljanje izveštaja, kao završetak projekta uopšte.

Izveštaj nastavlja objašnjava metodologiju korišćenu za prikupljanje podataka, koji su postupci, alati i koraci korišćeni za postizanje unapred određenog cilja, kao i predstavlja niz izazova sa kojima se susreće tokom praćenja. Podaci koji se nalaze u izveštaju se izrađuju u pisanom i grafičkom obliku.

Treći deo predstavlja opštu i specifičnu procenu. Obuhvata unutrašnji stručni jezički kapacitet opština i sudova, broj prevodilaca, ugovaranje jezičkih usluga, kao i nivo komunikacije i saradnje unutar institucije. Tokom praćenja, posebna pažnja je posvećena spremnosti institucija za saradnju i posvećenosti za primenu Zakona.

Četvrti deo sadrži završetak i zaključke, kao i

institucioneve për bashkëpunim dhe angazhim për të zbatuar Ligjin.

Pjesa e katërt përmban përfundimin dhe konkluzionet, si dhe rekomandimet e përgjithshme dhe specifike, që ZKGGJ-ja i jep Institucioneve komunale dhe Gjykatave Themelore.

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Si vlerësim i përgjithshëm, mund të themi se Gjykatat Themelore qëndrojnë shumë më mirë se sa Institucionet e Komunës, në zbatimin e dispozitave të Ligjit.

Për herë të parë nëpër këto institucione është bërë monitorim së bashku me Institucionin e Avokatit të Popullit. Pas monitorimit dhe analizës së të dhënave, kur krahasojmë një periudhë afër katër vjeçare, në Komuna, janë evidentuar disa ndryshime që kanë vlerësuar se niveli i zbatueshmërisë së Ligjit nuk është i kënaqshëm. Edhe pse më herët është konstatuar se komunat kanë arritur një nivel të mirë të pjekurisë institucionale në përmbushjen e obligimeve ligjore, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave gjuhësore, kësaj radhe është vërejtur se Komunat kanë pësuar rënie të nivelit të zbatimit të Ligjit.

Komunat në përgjithësi kanë pothuajse të njëjtin nivel të performancës gjuhësore, për të theksuar se Prizreni dhe Graçanica qëndrojnë pak më mirë, përderisa është konstatuar se Gjykatat qëndrojnë më mirë në krahasim me Komunat.

Gjatë monitorimit u përdor edhe metoda, “klient i fshehtë”(secret customer) dhe në një rast, zyrtarja në Drejtorinë e Kadastrit në Pejë palës i është përgjigjur “unë veç shqip flas”, gjë që kjo bie në kundërshtim me Ligjin. Në rastin tjetër, në institucionin e komunës së Graçanicës, kur iu është drejtuar zyrtarit në gjuhën shqipe, edhe pse ai nuk ka ditur të përgjigjet në gjuhën shqipe, ka qenë i gatshëm të thërrasë përkthyesin, nëse kishte nevojë.

opšte i specifične preporuke koje KPJ daje opštinskim institucijama i osnovnim sudovima.

OPŠTA PROCENA

Kao opštu procenu, možemo reći da osnovni sudovi mnogo bolje stoje od opštinskih institucija u primeni odredbi Zakona.

Po prvi put je u ovim institucijama izvršeno praćenje zajedno sa Institucijom zaštitnika građana. Nakon praćenja i analize podataka, kada uporedimo period od skoro četiri godine, u opštinama su uočene promene koje su procenile da nivo primene Zakona nije zadovoljavajući. Iako je ranije utvrđeno da su opštine dostigle dobar stepen institucionalne zrelosti u ispunjavanju zakonskih obaveza, u zaštiti i unapređenju jezičkih prava, ovoga puta je uočeno da su opštine pretrpele pad u stepenu primene Zakona.

Opštine uopšteno imaju skoro isti nivo jezičkog učinka, da se istakne da Prizren i Gračanica stoje malo bolje, a utvrđeno je da sudovi stoje bolje u odnosu na opštine.

Prilikom praćenja korišćena je i metoda „tajnog kupca”(secret customer), a u jednom slučaju je službenik Uprave za katastar u Peći odgovorio stranci „Govorim samo albanski”, što je u suprotnosti sa Zakonom. U drugom slučaju, u instituciji opštine Gračanica, kada se službeniku obratio na albanskom jeziku, iako nije znao da odgovori na albanskom, bio je spreman da pozove prevodioca, ukoliko postoji potreba.

Përveç kësaj, ekipi monitorues ka evidentuar se:

- Edhe përkundër mangësive të evidentuara, si mjaft e rëndësishme, dygjuhësia është një standard që respektohet në Komuna dhe në Gjykata.
- Mbishkrimet orientuese nëpër Gjykata janë pothuajse në nivel shumë të kënaqshëm, përjashtuar në dy raste (Graçanicë dhe Prishtinë, në sportelet hyrëse). Nëpër Komuna ka laramani (Pejë, Gjilan), dhe mjaft mangësi (në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe Prishtinës).
- Sipas deklaratave të zyrtarëve të institucioneve të vizituara, takimet, dokumentet, aktet komunale, formularët, të gjitha përkthehen në të dy gjuhët, por ka raste kur një vendim apo një formular jepet vetëm në gjuhën e kërkuarit. Për shkak të kapaciteteve të kufizuara profesionale, ka mjaft vështirësi në përmbushjen e kërkesave.
- Të gjitha Komunitat dhe Gjykatat kanë kryesisht nga një përkthyes, ndërsa numri më i madh i përkthyesve nëpër Komuna është 3 (tre), ndërsa në Gjykata 13 (trembëdhjetë).
- Komunitat kanë deklaruar se nuk kanë kompani të kontraktuar përkthimi, përveç Komunës së Prizrenit e cila ka deklaruar se ka marrëveshje me kompani të përkthimit.
- Te Gjykatat gjendja qëndron më mirë dhe numri më i madh i përkthyesve është 13 (trembëdhjetë), por edhe pse ka gjykata me më pak përkthyes, për sa i përket çështjes gjuhësore shërbimet bëhen me rregull dhe pa pengesa.
- Asnjë Komunë nuk ka linjë buxhetore të veçantë për përkthime, edhe përkundër faktit se ZKGG-ja ka dhënë disa herë rekomandime për këtë çështje.
- Te komunitat me shumicë serbe, zyrtarët komunal kanë vërejtje se kriteret për konkurs janë të larta dhe vështirë të gjenden persona që i përmbushin të njëjtat.
- Komunitat, por në disa raste edhe

Pored toga, tim za praćenje je zabeležio da:

- je i pored uočenih nedostataka, kao veoma bitnih, dvojezičnost standard koji se poštuje u opštinama i u sudovima.
- su orijentacioni natpisi u sudovima skoro na veoma zadovoljavajućem nivou, izuzev u dva slučaja (Gračanica i Priština, na ulaznim šalterima). Širom opština postoje raznolikosti (Peć, Gnjilane) i mnogi nedostaci (u Opštini Južna Mitrovica i Priština).
- Prema izjavama službenika posećenih institucija, sastanci, dokumenti, opštinski akti, obrasci su prevedeni na oba jezika, ali postoje slučajevi kada se odluka ili obrazac daje samo na jeziku podnosioca zahteva. Zbog ograničenih stručnih kapaciteta, postoje mnoge poteškoće u ispunjavanju zahteva.
- Sve opštine i sudovi uglavnom imaju jednog prevodioca, a najveći broj prevodilaca u opštinama je 3 (tri), a u sudu 13 (trinaest).
- Opštine su izjavile da nemaju ugovorene prevodilačke kompanije, izuzev opštine Prizren, koja je izjavila da ima ugovor sa prevodilačkom kompanijom.
- U sudovima je situacija bolja i najveći broj prevodilaca je 13 (trinaest), ali iako ima sudova sa manje prevodilaca, što se tiče jezika, usluge se pružaju redovno i bez prepreka.
- Nijedna opština nema posebnu budžetsku liniju za prevode, uprkos činjenici da je KPJ dala nekoliko preporuka po ovom pitanju.
- U opštinama sa srpskom većinom, opštinski službenici napominju da su kriterijumi za konkurs visoki i da je teško naći ljude koji ih ispunjavaju.
- Opštine, ali u nekim slučajevima i sudovi, se žale da nemaju poseban budžet za prijem novih prevodilaca, uprkos činjenici da imaju potrebe.
- U opštinama je od strane prevodilaca izneta kao zabrinutost činjenica da se sudska rešenja ne prevode, a kada dođu u opštinu, trebaju biti prevedena od strane od strane prevodilaca koji nisu sudske prevodioci. Kao posledica toga može doći do grešaka.
- Podnet je i zahtev da KPJ održi obuke u opštinama o Zakonu o upotrebi jezika, zbog toga što, kako su rekli, ima slučajeva da

Gjykatat, janë ankuar se nuk kanë buxhet të caktuar për të pranuar përkthyes të rinj, edhe përkundër faktit se kanë nevojë.

- Nëpër Komuna nga përkthyesit është paraqitur si shqetësim fakti se vendimet e gjykatës nuk janë duke u përkthyer, dhe kur ato vijnë në komunë, duhet të përkthehen nga përkthyesit që nuk janë përkthyes gjyqësor. Si rrjedhojë mund të ketë gabime.
- U parashtrua edhe kërkesa që ZKGGJ-ja të mbajë trajnime nëpër komuna për Ligjin për përdorimin e gjuhëve, për faktin se siç thanë ata, ka raste kur zyrtarët nuk e kuptojnë në tërësi dhe vështirë të bëjnë dallimin në mes të gjuhës zyrtare dhe gjuhës në përdorim zyrtar në nivel lokal.
- Duhet veçuar se Komuna e Mitrovicës së veriut nuk ka fare ueb faqe të internetit. Sipas zv. kryetares, kërkesa është bërë por janë ende në pritje të realizimit të kërkesës.



Takim me kryetarin e Komunës së Prizrenit dhe Gjilanit / Sastanak sa gradonačelnikom Opštine Prizren i Gnjilane

VLERËSIMI SPECIFIK

- **Përkthyesit në Komuna dhe Gjykata**

Kur kemi të bëjmë me Komunitat e monitoruara, përveç Gjuhës Shqipe dhe Serbe si gjuhë zyrtare në nivel qendror, Gjuha Boshnjake dhe Gjuha Turke janë gjuhë zyrtare në nivel lokal në komunën e Pejës, Prizrenit. Gjuha Turke është gjuhë në përdorim zyrtar në Komunën e Gjilanit, Mitrovicës dhe Prishtinës, ndërsa Gjuha Rome, është gjuhë në përdorim zyrtar në Graçanicë dhe Prizren.

Komunitat kanë të punësuar përkthyesit, ku shumica e tyre kryesisht janë për versionin

službenici ne razumeju u potpunosti i teško prave razliku između službenog jezika i jezika u službenoj upotrebi na lokalnom nivou.

- Treba napomenuti da opština Severna Mitrovica uopšte nema internet stranicu. Prema rečima zamenika predsednika, zahtev je podnet ,ali se još uvek čeka da zahtev bude ispunjen.

SPECIFIČNA PROCENA

- **Prevodioci u Opštinama i Sudovima**

Kada se bavimo praćenim opštinama, pored albanskog i srpskog kao službenih jezika na centralnom nivou, bosanski i turski su službeni jezici na lokalnom nivou u opštini Peć i Prizren. Turski jezik je jezik u službenoj upotrebi u Opštini Gnjilane, Mitrovica i Priština, a romski jezik je u službenoj upotrebi u Gračanici i Prizrenu.

Opštine zapošljavaju prevodioce, od kojih je većina uglavnom za albansko-srpsku verziju i

shqip- serbisht dhe anasjelltas. Nëpër Komuna numri më i vogël i përkthyesve është një (1), ndërsa numri më i madh i tyre është në Prizren (3 përkthyes). Në disa komuna kanë deklaruar se kanë shpallur konkurs për përkthyes, por është vështirë të gjejnë kandidat që plotëson kushtet, për faktin se ka mungesë të kuadrove përkatëse, si dhe mungesë të buxhetit. Në disa raste, sipas tyre, në rrethanat kur është paraqitur nevoja, në ndihmë iu ka dalë edhe OSBE-ja me përkthyesit e vet. Në rastet kur ka nevojë, në disa Komuna ndihmojnë edhe zyrtarët që njohin dy apo tri gjuhë, si dhe zyrtarët e komuniteteve që kanë njohuri të gjuhëve të mjedisit, kështu që nuk ka ndodhur të ketë reagime dhe pakënaqësi nga qytetarët.

Shqetësim tjetër i zyrtarëve komunalë ishte që dokumentet e dërguara nga gjykatat në komunë janë vetëm në njëren gjuhë, kështu që përkthyesit komunalë duhet ti përkthejnë ato dhe jo vetëm që ngarkohen më punë shtesë, por ekziston edhe shqetësimi tjetër se ata nuk janë përkthyes gjyqësor të licencuar dhe mund të bëjnë gabime.

Me përkrahjen e IOM-it, në dy komuna, është angazhuar nga një përkthyes për gjuhën rome, për një afat kohor prej gjashtë (6) muajsh, por në kohën e vizitave monitoruese kemi kuptuar se përkthyesi në Komunën e Prizrenit nuk është angazhuar ende, me arsyetimin e kryetarit se janë të interesuar që të bëjnë një zgjidhje afatgjatë, dhe ky proces po merr pak më tepër kohë. Në komunën e Graçanicës, përkthyesi për gjuhën rome kishte filluar punën. Nëpër gjykata gjendja qëndron më mirë, ku numri më i madh i përkthyesve është trembëdhjetë (13), (Gjykata Themelore në Mitrovicë) dhe numri më i vogël është një (1). Sipas nevojës gjykatat angazhojnë përkthyes nga lista e përkthyesve të Këshillit Gjyqësor të cilët janë të licencuar.

obratno. U opština je najmanji broj prevodilaca jedan (1), a najveći broj je u Prizrenu (3 prevodioca). U nekim opština su objavili da su raspisali konkurs za prevodioce, ali je teško naći kandidata koji ispunjava uslove, zbog nedostatka odgovarajućih kadrova, kao i nedostatka budžeta. U nekim slučajevima, prema njihovim rečima, u okolnostima kada se ukazala potreba, OEBS im je priskočio u pomoć sa svojim prevodiocima. U slučajevima kada postoji potreba, u pojedinim opština pomažu i službenici koji znaju dva ili tri jezika, kao i službenici zajednice koji poznaju jezike sredine, tako da nije bilo reakcija i nezadovoljstva građana.

Još jedna zabrinutost opštinskih zvaničnika je bila što su dokumenti koje sudovi šalju opštini samo na jednom jeziku, pa ih opštinski prevodioci moraju prevoditi i ne samo da su opterećeni dodatnim poslom, već postoji i druga zabrinutost zato što su nisu licencirani sudski prevodioci i mogu načine greške.

Uz podršku IOM-a, u dve opštine je angažovan prevodilac za romski jezik, na period od šest (6) meseci, ali smo u vreme terenskih poseta shvatili da prevodilac u opštini Prizren još nije angažovani, uz obrazloženje predsednika opštine da su zainteresovani da donesu dugoročno rešenje, a ovaj proces oduzima malo više vremena. U opštini Gračanica je počeo da radi prevodilac za romski jezik.

U sudovima je situacija bolja, gde je najveći broj prevodilaca trinaest (13), (Osnovni sud u Mitrovici), a najmanji jedan (1).

Sudovi po potrebi angažuju prevodioce spiska prevodilaca Sudskog saveta koji su licencirani.




Fig. 2: Numri i përkthyesve në komuna dhe në gjykata / Broj prevodioca u opštinama i sudstvima

- **Kontraktimi i shërbimeve gjuhësore**

Zyra e Komisionerit për gjuhët, vazhdimisht ka vlerësuar se zbatimi i mirëfilltë i Ligjit mund të bëhet kur institucionet kanë përkthyes të punësuar, por në rastet kur institucionet e cilit do nivel nuk kanë të punësuar përkthyes për gjuhët zyrtare, ata janë të obliguar që të kontraktojnë kompani përkthimi nga jashtë.

Lidhur me këtë, Komunitat dhe Gjykatat janë pyetur se a kanë edhe për shërbime përkthimi nga jashtë.

